

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7875
E martë, 2 shtator 2024
Çmimi 0.50 €

BE-ja e konsideron
prioritet raundin e ri të
dialogut Kosovë - Serbi

PAGE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUPCHAN: MANOVRAT NË VERI I SHËRBEJNË KURTIT, JO KOSOVËS

PAGE 4-5



Ish-drejtori i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, Charles Kupchan,

beson se veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri të vendit janë të motivuara nga politika e

brendshme përpara zgjedhjeve të shkurtit, por thekson se ato janë të rrezikshme për Kosovën

**FILLON VITI I RI
SHKOLLOR,
PARALAJMËROHEN
VEPRIME
SINDIKALE
NË MUNGESË
TË DIALOGUT** F.3



**A PO NXITET NJË KONFLIKT
I RI I ARMATOSUR** F.7



Shkruan: Milazim KRASNIQI

AKTUALE



**PARTIA E EKSTREMIT TË DJATHTË
FITON PËR HERË TË PARË NË
ZGJEDHJET RAJONALE GJERMANE**

F.2

**PROKURORIA: PËRLESHJA E
ARMATOSUR NË PRISHTINË U NXIT
NGA MOSMARRËVESHJET MES DY
GRUPEVE** F.7

**BISERKO KËRKON VERIFIKIMIN
E INFORMACIONEVE SE NË SERBI
PO NDËRTOHEN SHTËPI
PËR SERBË NGA KOSOVA** F.5

EKONOMI



**ÇMIMET E KONSUMIT SHËNOJNË
NGRITJE 2.2 %** F.8

**GASTRONOMËT ANKOHEN SE IU KA
RËNË PUNA, TREGOJNË DISA
ARSYE QË KANË ÇUAR NË ULJE** F.8

SPORT



**FODA: SYNOJMË FITORE
KUNDËR RUMANISË DHE
VENDIN E PARË NË GRUP** F.10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

HRW i bën thirrje Mongolisë ta arrestojë ose t'ia mohojë hyrjen Putin

ULAN BATOR, 2 SHTATOR - Organizata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Human Rights Watch (HRW), i ka bërë thirrje Mongolisë t'ia mohojë hyrjen, ose ta arrestojë presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, i cili e ka ndër mend ta vizitojë këtë vend më 3 shtator. Putini kërkohet nga Gjykata

Ndërkombëtare Penale (GJNP), së cilës Mongolia iu bashkua më 2003. GjNP-ja, një gjykatë e përhershme për krimet e luftës me seli në Hagë, më 2023 e lëshoi një urdhërarrest për Putinin për dëbimin e dyshuar të fëmijëve nga Ukraina, gjë që cilësohet krim lufte. "Mongolia do t'i shpërfillë detyrimet e saj

ndërkombëtare si një anëtare e GjNP-së nëse e lejon vizitën [e Putinit] pa e arrestuar atë", tha të hënën Maria Elena Vignoli, avokate e lartë ndërkombëtare në HRW. Kremlinin tha më 30 gusht se nuk "bregoset" për udhëtimin e Putinit, duke shtuar se Rusia ka "dialog të mrekullueshëm me miqtë tanë nga Mongolia".



Partia e ekstremit të djathtë fiton për herë të parë në zgjedhjet rajonale gjermane

BERLIN, 2 SHTATOR - Partia e ekstremit të djathtë, Alternativa për Gjermaninë (AfD), ka shënuar rezultate historike në zgjedhjet rajonale të së dielës. Rezultatet preliminare i kanë dhënë kësaj partie fitore të qartë në Turingia, ndërkaq ky subjekt është i dyti, me një diferencë të ngushtë në Saksoni.

Fitorja e AfD-së në Turingia është fitorja e parë në zgjedhje në Gjermani e një partie të ekstremit të djathtë që nga mposhtja e Gjermanisë Naziste në Luftën e Dytë Botërore.

Sipas rezultateve preliminare, në Turingia, AfD-ja ka fituar 32.8 për qind të votave, duke lënë pas CDU-në me 23.6 për qind.

Në Saksoni, Demokristianët (CDU), që aktualisht janë në pushtet, sipas rezultateve preliminare, kanë një epërsi të



vogël ndaj AfD-së. CDU-ja ka fituar 31.9 për qind të votave, ndërkaq AfD-ja 30.6 për qind. Rezultatet e zgjedhjeve dhe më pas bisedimet për koalicion do ta përcaktojnë balancën e pushtetit në parlamentet shtetërore të Turingias dhe Saksonisë, që kanë

fuqi të konsiderueshme mbi çështjet rajonale. Ndërkaq, tri partitë e koalicionit qeverisës të kancelarit Olaf Scholz u përballën me humbje. Rezultati i këtyre zgjedhjeve mund ta thellojë edhe më shumë përçarjen në mes të parterëve të

koalicionit vetëm një vit para se Gjermania t'i mbajë zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, të caktuara për shtatorin e vitit 2025. Pavarësisht prej përfitimeve të mëdha, AfD-ja nuk e ka fituar shumicën dhe ka pak gjasa të gjejë partnerë koalicioni si në Turingia, ashtu edhe në Saksoni, pasi politikanët nga kampet e tjera politike në këto lande kanë thënë se nuk do të bashkëpunojnë me partinë e ekstremit të djathtë.

Partitë e mëdha gjermane, përveçse kanë hedhur poshtë mundësinë e bashkëpunimit me AfD-në, vazhdimisht kanë thënë se kjo parti është shumë ekstreme dhe paraqet kërcënim për traditat demokratike të Gjermanisë.

Si Turingia ashtu edhe Saksonia ndodhën në vendin kur dikur ishte Gjermania Lindore. Shtetet janë relativisht të vogla - në të dyja

së bashku jetojnë pothuajse 7 për qind e popullatës së Gjermanisë por popullariteti në rritje i AfD-së në këtë rajon mori vëmendjen në mbarë vendin.

Edhe një tjetër parti populiste, që është formuar së fundi, Aleanca Sahra Wagenknecht (BSW) - parti e cila ka qëndrime kundër migrantëve dhe politika ekonomike të krahut të majtë, u rendit në vendin e tretë në të dyja shtetet.

Dalja në zgjedhje në Turingia dhe Sanksioni ishte e lartë 73.6 për qind, përkatësisht 74.4 për qind e votuesve morën pjesë në zgjedhje.

Zgjedhjet në shtetin tjetër lindor të Gjermanisë, në Brandenburg, do të mbahen më 22 shtator dhe, sipas sondazheve, AfD-ja po udhëheq edhe në këto zgjedhje parlamentare.

Sulmohen dy anije në Detin e Kuq

NEW DELHI, 2 SHTATOR - Dy anije dyshohet se janë sulmuar nga rebelët jemenas, Huthi, në Detin e Kuq, thanë autoritetet. Anijet u sulmuan afër vendit ku ekipet po tentojnë të shpëtojnë një cisternë të mbushur me naftë, e cila ende është e përfshirë nga flakët, pasi u sulmua nga rebelët jemenas në gusht.

Sulmet besohet se janë të fundit në fushatën e rebelëve që mbështeten nga Irani, e që kanë penguar kalimin e mallrave në vlerë prej 1 trilion dollarësh përmes Detit të Kuq.

Rebelët Huthi po kryejnë sulme ndaj anijeve për shkak të luftës në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur



organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Gazë. Sulmet e rebelëve, po ashtu, kanë penguar dërgesat e ndihmës për Sudanin dhe Jemenin, shtete të përfshira në konflikt.

Ndërkaq, përpjekjet për ta shpëtuar cisternën me naftë të përfshirë nga zjarri ende po vazhdojnë, teksa ka shqetësime se djegia e saj mund të shkaktojë katastrofë ekologjike, pasi në bordin e cisternës janë 1 milion fuçi me naftë të papërpunuar. Në sulmin e së hënës dy predha goditën një anije, teksa një shpërthim ndodhi pranë anijes, tha ushtria britanike. "Nuk ka viktima në bord dhe anija po

vazhdon rrugën drejt portit", tha ushtria britanike.

Po të hënën ushtria britanike raportoi për një sulm të dytë nga rebelët Huthi. Një dron goditi një anije mallrash, por nuk u raportua për dëme apo të lënduar. Sulmi ndodhi vetëm disa kilometra larg nga vendi ku ndodhi sulmi ndaj cisternës së naftës, Blue Lagoon.

Rebelët Huthi nuk kanë marrë menjëherë përgjegjësinë për këto sulme. Ata kanë shpërndarë më shumë se 80 anije me raketa dhe dronë që kur ka nisur lufta në Gazë tetorin e vitit të kaluar. Rebelët jemenas, po ashtu, kanë fundosur dy anije dhe kanë vrarë katër detarë.

Nga rrëshqitja e dheut në Pakistan vdesin 12 veta, shumica fëmijë

Islamabad, 30 gusht - Një rrëshqitje dheu, e shkakuar nga shirat monsun, goditi një shtëpi në veriperëndim të Pakistanit, duke shkakuar vdekjen e 12 personave. Shumica e viktimave janë

fëmijë, tha një zyrtar i ekipeve të shpëtimit. Shërbimi i Emergjencave tha se incidenti ka ndodhur gjatë natës në provincën Khiber Paktunkva. Sipas tij, ekipet e shpëtimit kanë arritur të

nxjerrin trupat e pajetë të nëntë fëmijëve, dy grave dhe një burri. Autoritetet kanë paralajmëruar se shirat e furishëm, që kanë nisur muajin e kaluar, mund të

shkaktojnë rrëshqitje dheu dhe përmytje në Pakistan. Që nga 1 korriku mbi 275 njerëz kanë vdekur në incidente të lidhura me shirat në pjesë të ndryshme të këtij vendi.



Fillon viti i ri shkollor, paralajmërohen veprime sindikale në mungesë të dialogut

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Sindikatat e Bashkuara të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) kanë uruar mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit për fillimin e vitit të ri shkollor. Në një njoftim për medie, SBASHK-u ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe solidaritetit për t'i përballuar sfidat e vitit të ri akademik, duke nënvizuar angazhimin për arritje të reja në fushën e arsimit. "Edhe në këtë vit shkollor do të përballemi me shumë sfida, por bashkërisht mund t'i

tejkalojmë më lehtë", thuhet në njoftim. SBASHK-u, po ashtu, ka bërë me dije se do t'i vazhdojë përpjekjet për zgjidhjen e kërkesave legjitime të anëtarëve të saj përmes dialogut me qeverinë dhe institucionet përkatëse. Megjithatë, sindikata ka paralajmëruar se nëse dialogu nuk jep rezultat, mund të ndërmerren veprime sindikale sipas vullnetit të anëtarësisë. "Ne do të vazhdojmë aktivitetet dhe komunikimin me institucionet dhe palët e tjera me qëllim që t'i

realizojmë gjithë kërkesat e anëtarësisë, por nëse dialogu nuk jep asnjë rezultat, atëherë do të respektojmë vullnetin tuaj edhe për veprime sindikale për të cilat vendosin përfaqësuesit tuaj që nga çerdhet e deri në universitete në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut. Urime viti i ri shkollor dhe na priftë e mbara bashkë e në SBASHK", thuhet në urimin e SBASHK-ut, duke shprehur shpresën për një vit të suksesshëm dhe produktiv për të gjithë pjesëmarrësit në procesin arsimor.



BE-ja e konsideron prioritet raundin e ri të dialogut Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Bashkimi Evropian e konsideron prioritet organizimin e raundit të ri të dialogut Kosovë - Serbi në nivel kryenegociatorësh. Por, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, nuk dha ndonjë datë për një takim të tillë, duke thënë se data do të bëhet publike në një kohë të përshtatshme. Një ditë më parë i dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, tha se do të qëndrojë në Prishtinë për ta

përgatitur raundin e ri të dialogut, duke mos dhënë më shumë detaje. "Si zakonisht, takimet i paralajmërojmë kur të jetë e përshtatshme. Takimet në nivel të kryenegociatorëve nuk i paralajmërojmë zakonisht për medie. Por, padyshim qëllimi ynë është që sa më parë të kemi takim në nivel kryenegociatorësh sepse ka një varg çështjesh për të diskutuar", tha Stano. Gjatë konferencës për medie në Bruksel, Stano u pyet lidhur me

mbylljen e pesë institucioneve paralele serbe nga Kosova javën e kaluar. Ai përsëriti qëndrimin e shprehur nga blloku se këto veprime janë të njëanshme dhe të pakoordinuara, me potencial të rritjes së tensioneve. Edhe Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar kanë kritikuar veprimet e Kosovës në veri. Nga Qeveria e Kosovës kanë thënë se institucionet e mbyllura në veri të Kosovës punonin në

udhëheqjen e Serbisë, duke e "cenuar kushtetutshmërinë dhe ligjet e Republikës së Kosovës". Përveç pesë institucioneve të mbyllura të premten e kaluar, në prill autoritetet e Kosovës mbyllën edhe shtatë komuna të tjera paralele serbe në pjesë të tjera të Kosovës. Në Kosovë ka komuna, kompani dhe ndërmarrje publike, çerdhe, shkolla fillore, të mesme dhe universitete publike që financohen drejtpërdrejt nga

Qeveria e Serbisë, të cilat gjenden në qytetet dhe vendbanimet ku jeton komuniteti serb. Këto institucione, sipas ligjeve në Kosovë, janë ilegale. Më 2013 Kosova dhe Serbia në dialogun për normalizimin e raporteve në Bruksel kishin arritur një marrëveshje për shuarjen e institucioneve paralele, por ende kjo marrëveshje nuk është zbatuar plotësisht.


Ministria e Mbrojtjes hap konkurs për pranimin e 300 ushtarëve të rinj

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ministria e Mbrojtjes ka njoftuar se ka hapur konkurs për pranimin e 300 ushtarëve të rinj. Sipas kësaj

ministrie, konkursi do të jetë i hapur nga data 9 shtator deri më 8 tetor 2024, ndërsa të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit nga

mosha 18 deri 25 vjeç. "Të gjithë të interesuarit për t'u bërë pjesë e Ushtrisë së Kosovës, mund të aplikojnë në ueb faqen e Ministrisë së

Mbrojtjes, duke plotësuar formularin i cili së shpejti do të publikohet. Bëhu ushtar i Kosovës", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.





Kupchan: Manovrat në veri i shërbejnë Kurtit, jo Kosovës

Ish-drejtori i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, Charles Kupchan, beson se veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri të vendit janë të motivuara nga politika e brendshme përpara zgjedhjeve të shkurtit, por thekson se ato janë të rrezikshme për Kosovën

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Charles Kupchan, ish-drejtor i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, beson se veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri të vendit janë të motivuara nga politika e brendshme përpara zgjedhjeve të shkurtit, por thekson se ato janë të rrezikshme për Kosovën. Të premtën e kaluar qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti mbylli disa institucione paralele serbe në veri të vendit. Aksioni nxiti reagimin e NATO-s, Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të tjera perëndimore, të cilat e cilësuan "të pakoordinuar" me aleatët perëndimorë dhe me rrezik për sigurinë. "Për mua këto janë gjeste dhe manovra në nivel të politikës së brendshme, të cilat mund të jenë të mira për fatin politik të [kryeministrit Albin] Kurti, por nuk janë të mira për Kosovën", thotë Kupchan për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij,

Kosova duhet ta balancojë ushtrimin e sovranitetit me synimin për t'i normalizuar marrëdhëniet me Serbinë dhe për t'u bërë vend anëtar i BE-së dhe NATO-s.

Kosova u përball në fundjavë me disa nga kritikët më të ashpra ndërkombëtarë kundër saj pas mbylljes së disa institucioneve paralele serbe në veri. ShBA-ja tha se ky veprim pasqyron "përkeqësimin e marrëdhënieve tona". NATO-ja u shpreh, po ashtu, e zhgënjyer. Sa serioze mendoni se është situata?

Charles Kupchan: Mendoj se është veçanërisht shqetësuese, sepse vjen pas një sërë hapash që ka ndërmarë Qeveria e Kurtit - prej se ka ardhur në pushtet - e që kanë penguar dialogun me Serbinë dhe kanë rrezikuar marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian. Qoftë ndalimi i përdorimit të dinarit, qoftë

detyrimi për ndryshimin e targave, përpjekja për hapjen e urës së Ibrit, përpjekja e njëanshme për t'i instaluar kryetarët e komunave në veri, edhe pse janë zgjedhur nga një pakicë e vogël votuesish, apo tani mbyllja e këtyre institucioneve paralele... këta nuk janë hapa të dobishëm. Por, tani që zgjedhjet në Kosovë janë shpallur për muajin shkurt, mendoj që Kurti po pozicionohet për t'ia dalë mirë në atë proces. E dimë se kudo në botë, por sidomos në Ballkan, nacionalizmi funksionon mirë. Unë mendoj se Kurti po e bën pikërisht këtë. Por, sipas vlerësimit tim, është dritëshkurtër, sepse e minon mbështetjen e Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare dhe nuk ndihmon për ta çuar përpara dialogun me Serbinë - përkundrazi, e kthen prapa. Për mua, këto janë gjeste dhe manovra në nivel të politikës së brendshme, të cilat mund të jenë të mira për fatin politik të Kurtit, por nuk janë të mira për Kosovën.

Por, sa ka kuptim ky presion ndaj Kosovës kur dihet se për shuarjen e strukturave paralele ekziston një marrëveshje e arritur në Bruksel?

Charles Kupchan: Mendoj se ka

kuptim, sepse korniza [e Marrëveshjes së Ohrit] - që është krijuar pastaj nga BE-ja, dhe për të cilën Kurti dhe [presidenti i Serbisë, Aleksandar] Vuçiq kanë rënë dakord, edhe pse nuk e kanë nënshkruar - bazohet në reciprocitet, në të ecurit përpara bashkë dhe jo ndaras. Kritikat janë të nevojshme. Kosova dhe Serbia kanë zgjedhje të vështira për të bërë. Udhëheqësit e tyre përballen me stimuj të brendshëm, për të bërë pikërisht atë që Kurti po bën. Dhe, duke kritikuar Prishtinën nga jashtë, bashkësia ndërkombëtare krijon stimuj për Kurtin, për Vuçiqin, për të tjerët, që të lëvizin në një drejtim më konstruktiv. Pra, nuk është vetëm një kritikë e thjeshtë, është një kritikë që synon t'i rregullojë politikën që ndjekin palët.

Sa keq mund të shkojnë gjërat?

Charles Kupchan: Në kemi parë tashmë shpërthime dhune. Nuk besoj se po shkojmë drejt një dhune të madhe, por nuk përjashtohet. Kemi parë që edhe KFOR-i e ka rritur nivelin e forcave. Ditëve të fundit, kam parë fotografi të trupave që qëndrojnë mes urës së Ibrit. Supozoj se mund të jenë shqetësuar për kalimin e mundshëm të aktivistëve, që do të përpiqeshin të nxisnin telashe.

Është një moment i tensionuar dhe për mua kjo është një nga arsyet përse komuniteti ndërkombëtar e ka ngritur nivelin e vigjilencës.

A mund të ndodhë që ShBA-ja ose NATO-ja t'ia kthejë shpinën Kosovës?

Charles Kupchan: Unë nuk besoj se kjo është një pikë kthese në mbështetjen e Perëndimit për Kosovën. Por, është e rëndësishme që qytetarët e Kosovës ta kenë parasysh faktin se po të mos ishin përpjekjet e Shteteve të Bashkuara, përpjekjet e NATO-s dhe të partnerëve evropianë të Amerikës, Kosova ndoshta nuk do ta gëzonte pavarësinë sot. Për rrjedhojë, ju nuk dëshironi ta rrezikoni mbështetjen e jashtme, që në shumë aspekte është thelbësore për sigurinë tuaj dhe për qëndrueshmërinë tuaj si vend i pavarur.

A mendoni se Qeveria e Kosovës mund të gjejë ndonjë mes - edhe ta shtrijë ligjshmërinë dhe sovranitetin, edhe t'i ruajë marrëdhëniet e mira me komunitetin ndërkombëtar?

Charles Kupchan: Realiteti është se hapat që po ndërmer Kurti, nuk janë të paarsyeshëm nga këndvështrimi i ushtrimit të pushtetit sovran. Atë që po bën

Biserko kërkon verifikimin e informacioneve se në Serbi po ndërtohen shtëpi për serbë nga Kosova

Prishtinë, 2 shtator - Kryetarja e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Sonja Biserko, tha se ia ka përcjellë kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, shqetësimet për disa informacione nga Serbia, se në rajonin e Sanxhakut në këtë vend, "janë duke u ndërtuar shtëpi dhe banesa për serbët e Kosovës, sidomos ata nga veri", por theksoi se informacionet e tilla duhet të verifikohen.

Një ditë më herët Qeveria e Kosovës njoftoi se Kurti ka pritur në takim Biserkon, bashkë me Nenad Çanakun, ish-udhëheqës i

partisë së qendrës së majtë, Lidhja e Social-Demokratëve të Vojvodinës, dhe Mark Baskinin, këshilltar i lartë i Qendrës për Dialog Humanitar.

Në komunikatën e publikuar u tha se mysafirët e njoftuan Kurtin se në Serbi flitet për një mundësi të tillë. "Si dikush që është marrë me çështjen e refugjatëve që nga vitet 1990 e kënde, ju kujtoj se gjithmonë ka pasur thashetheme, të cilat më vonë kanë rezultuar me eksod apo zhvendosje të popullsisë", tha Biserko në një deklaratë për Radion Evropë e Lirë. "Ne i kemi thënë Qeverisë së

Kosovës që duhet t'u kushtojë vëmendje këtyre informacioneve dhe të bëjë gjithçka të mundur që popullata serbe të mbahet në veri të Kosovës", tha Biserko.

Sipas saj, i takon shoqërisë dhe Qeverisë së Kosovës, ashtu si edhe organizatave civile dhe ndërkombëtare, që të verifikojnë se sa të sakta janë këto informacione. Radio Evropa e Lirë pyeti zëdhënësin e Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, se si synon ky institucion të veprojë pas këtyre informacioneve, por nuk mori përgjigje.

Nga institucionet në Serbi nuk

kishte ndonjë reagim pas publikimit të informacionit për takimin e Kurtit me Biserkon, Çanakun dhe Baskinin.

REL-i kontaktoi kabinetin e presidentit të Serbisë, Qeverinë e Serbisë dhe Zyrën për Kosovën në Beograd, por asnjëri institucion nuk u përgjigj.

Në Kosovë janë dhjetë komuna me shumicë serbe të shpërndara në veri dhe në jug të lumit Ibër.

Numri i saktë i popullsisë nuk dihet, pasi serbët e katër komunave në veri - Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - e kanë bojkotuar

kryesisht regjistrimin e popullsisë që është bërë në pranverë të këtij viti.

Sipas të dhënave paraprake të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të publikuara më 12 korrik, vetëm rreth 6 500 njerëz në këtë zonë i janë përgjigjur regjistrimit, ndërsa atje besohet se jetojnë dhjetëra mijëra.

Kjo pjesë, e diriguar nga Serbia dhe strukturat e saj paralele atje, nuk u bindet lehtësisht vendimeve të Qeverisë së Kosovës që nga paslufta më 1999. Për pasojë, shpesh është bërë edhe vatër protestash e tensionesh.



Prishtina, do ta bënte çdo qeveri sovraane. Nëse në Teksas, për shembull, Meksika do të hapte institucione paralele dhe do të ofronte kujdes shëndetësor, siguri dhe lloje të tjera shërbimesh komunale, Shtetet e Bashkuara nuk do të ishin të lumtura dhe, në fakt, do t'i mbyllnin ato institucione paralele. Kështu që, nga perspektiva e autoritetit politik dhe ligjor, ajo që po bën Kurti, ka shumë kuptim. Por, problemi është se Kosova nuk gjendet në një mjedis të qetë. Ajo gjendet në një mjedis të tensionuar, në një rajon të vështirë, në mes të negociatave shumë të vështira me Serbinë për njohjen e saj, për hyrjen e saj në bashkësinë ndërkombëtare të kombeve, si një vend që do të pranohej nga të gjithë.

Në rrethana të tilla, unë mendoj se i takon udhëheqësit - kushdo qoftë ai - që të balancojë ushtrimin e sovranitetit, të të drejtave politike dhe ligjore me synimin për t'i normalizuar marrëdhëniet me Serbinë dhe për t'u bërë vend anëtar i BE-së dhe NATO-s.

Por, Kosova ndien, po ashtu, se nuk trajtohet në mënyrë të barabartë nga bashkësia ndërkombëtare. Këtë kritikë ndaj Bashkimit Evropian e ka përsëritur të shtunën edhe presidentja Vjosa Osmani kur ka thënë se Kosova nuk ka barazi në procesin e dialogut me Serbinë. Si do t'i komentoni këto pretendime?

Charles Kupchan: Unë mendoj se gjithmonë duhet pasur parasysh fundin. Në çdo front të

caktuar, qoftë për dinarin, për targarat apo për institucionet paralele, Kosova ka të drejtë të thotë se nuk po na trajtoni me drejtësi, se ne duam të jemi një vend si çdo vend tjetër. Por, në anën tjetër, nëse gjykohet sjellja e Kosovës nga perspektiva se a e ndihmon kjo gjë atë, a e çon drejt vijës së finishit, si dhe a e afron Gadishullin Ballkanik më pranë pluralizmit, multietnicitetit, stabilitetit dhe integritetit në institucionet atlantike, atëherë ka një përgjigje tjetër - këta hapa nuk janë të dobishëm. Nisur nga fakti se bashkësia ndërkombëtare i ka sytë te qëllimi i fundit, unë mendoj se kritikën ndaj Qeverisë në Prishtinë janë të justifikuar.

E përmendët më herët urën e

Ibrit. Komuniteti ndërkombëtar e ka paralajmëruar Kosovën kundër hapjes së saj për qarkullimin e makinave në këto momente. Marrë parasysh ngjarjet e fundit, a është reale të pritët që Kosova mund ta bëjë një veprim të tillë këto ditë?

Charles Kupchan: Mendoj se ngjarjet e fundit e bëjnë edhe më të rrezikshme hapjen e njëanshme të urës. Sepse, mbyllja e institucioneve paralele sigurisht që do ta mobilizojë popullatën shumicë serbe në veri që të jetë vigjilente, të thotë se ju po bëni gjëra që kërcënojnë cilësinë tonë të jetesës dhe lidhjet tona me Serbinë. Pra, nuk është koha për të ndërmarrë hapa që, potencialisht, mund të çojnë në përplasje midis shqiptarëve etnikë dhe serbëve etnikë.

I dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajcak, ka paralajmëruar të dielën përpjekje të reja për ripërtëritjen e dialogut Kosovë - Serbi. A mendoni se mund të ketë ndonjë rezultat?

Charles Kupchan: Herët a vonë, po. Me gjasë, më vonë. Tani për tani, nuk duket se jemi në një situatë, ku ka përpjekje konstruktive nga Prishtina dhe Beogradi. Rundi i fundit i bisedimeve, në të cilin Kurti dhe Vuçiq është dashur të takohen, nuk është zhvilluar kurrë. Kjo nuk është një shenjë e mirë. Me afrimin e zgjedhjeve në Kosovë, dyshoj se do të shohim ndonjë qasje ndryshe nga Prishtina. Për pasojë, mendoj se përparimi në dialog ndoshta do të duhet të presë zgjedhjet e shkurtit.

Shkolla në Gexhë të Rahovecit, gati për fillim të mbarë të vitit të ri shkollor

RAHOVEC, 2 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në përrurimin e renovimit të plotë të hapësirave të brendshme të ShFMU "Skënder Kastrati", paralelja e ndarë në Gexhë. Latifi ka

thënë se ky objekt shkollor duket si të jetë i ndërtuar tani. "Aty janë krijuar kushte të mira për mësim për nxënësit dhe për mësimdhënësit. Punimet e jashtme të shkollës u realizuan muaj më parë

(eficiencia e energjisë), ndërsa brendësia e objektit është në nivelin e duhur për fillim të mbarë të vitit të ri shkollor. Me këtë rast, i uruam mësimdhënësit dhe nxënësit për një vit të suksesshëm dhe plot arritje.

Ky investim është një dëshmi e qartë e përkushtimit tonë për të ofruar arsim cilësor dhe për t'i ngritur standardet në mësimdhënie dhe në mësimnxënie", ka thënë kryetari Latifi.



Nga janari e deri më sot janë raportuar 258 raste të dhunës në familje në Pejë



PEJË, 2 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka vizituar të hënën Prokurorinë Themelore në Pejë. Ajo është pritur nga kryeprokurori Agim Kurmehaj dhe zëvendëskryeprokurori Ersan Çavolli. "I njoftova për prioritetet tona që ndërlidhen me reformën, punën që po bëjmë me fokus në adresimin e dhunës në familje, ku vetëm nga janari e deri më sot në komunën e Pejës janë raportuar 258 raste të dhunës në familje si dhe i njoftova për politikën në fuqizimin e ligjeve dhe mekanizmave që merren me

luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin. U njoftova për angazhimin e tyre sidomos për këto raste dhe për numrin e vogël të prokurorëve 11 nga 19 prokurorë sa ishin por që, pavarësisht kësaj, rezultatet nuk kanë munguar. Pas takimit vizitua hapësirat e kësaj prokurorie ku takuam prokurorë, bashkëpunëtorë profesionalë, zyrtarë ligjorë, ndërmjetësues dhe staf tjetër administrativ. Në fund i falënderova për punën dhe angazhimin dhe ua ofrova mbështetjen time për tejkalimin e sfidave", ka njoftuar Haxhiu.

Hyseni: Dokumentimi i krimeve të luftës është një detyrim ndaj kujtesës sonë si popull dhe ndaj kërkesës për drejtësi

GJILAN, 2 SHTATOR - Komisioni Komunal i komunës së Gjilanit ka dorëzuar përmbledhjen e punës në Institutin për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL). Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka treguar se bashkë me një pjesë të komisionit komunal për dokumentimin e krimeve të luftës, kanë pritur në takim At dhe Hetemin nga Instituti për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë.

I pari i komunës theksoi se i dorëzuan përmbledhjen e punës së gjatë të komisionit komunal. Më tej ai shtoi se ndërkohë do ta përgatisin edhe dokumentacionin e plotë që të dorëzohet në IKKL.



"Dokumentimi i krimeve të luftës është një detyrim ndaj kujtesës sonë si popull dhe ndaj

kërkesës sonë për drejtësi", tha kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni.

Totaj: Komuna e Prizrenit do të vazhdojë të investojë në infrastrukturën arsimore

PRIZREN, 2 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka thënë se fillimi i vitit të ri shkollor është gjithmonë moment i veçantë, që simbolizon një hap para në rrugën e dijes dhe zhvillimit personal. Ai ka thënë se komuna e Prizrenit do të vazhdojë të investojë në

përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe në ofrimin e kushteve sa më të mira për nxënësit dhe stafin mësimor. "Urime dhe suksese të gjithë nxënësve, sidomos atyre të klasave të para si dhe punë të mbarë gjithë personelit të shkollave!", ka uruar kryetari Totaj.



Përurohet kabineti i robotikës në Shkollën Teknikë "Arkitekt Sinani" në Mitrovicë

MITROVICË, 2 SHTATOR - Komuna e Mitrovicës ka përruruar kabinetin e robotikës në Shkollën e Mesme të Lartë Teknikë "Arkitekt Sinani". Krijimi i këtij kabineti është mundësuar nga donacioni i

KFOR-it turk dhe do t'u shërbejë nxënësve të kësaj shkolle, të cilët janë të interesuar për robotikë. "Ky kabinet përmban kompjuterë, printerë dhe të gjitha mjetet tjera përcjellëse, ku nxënësit e kësaj shkolle do

të kenë mundësi që të kuptojnë konceptet e kodimit, të jenë në hap me zhvillimet teknologjike, si dhe të jenë pjesëmarrës në gara të ndryshme ndërkombëtare", ka njoftuar komuna e Mitrovicës.



Prokuroria: Përleshja e armatosur në Prishtinë u nxit nga mosmarrëveshjet mes dy grupeve

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Mosmarrëveshjet e mëhershme mes dy grupeve të armatosura ishin shkaku i përleshjes së armatosur në Prishtinë mbrëmjen e 1 shtatorit, që la të vrarë një person, tha Prokuroria Themelore në Prishtinë. Sipas autoriteteve, ngjarja ndodhi të dielën në mbrëmje rreth orës 22:00 në rrugën

“Gazmend Zajmi” dhe gjatë të shtënave u plagosën edhe pesë persona. Prokuroria Themelore tha se pesë të dyshuarit, të cilët kanë marrë lëndime trupore, janë dërguar në Qendrën Klinike Universitare për trajtim dhe “për momentin janë jashtë rrezikut për jetë”. Autoritetet gjyqësore e kanë klasifikuar këtë rast si vepër

penale “vrasje të rëndë” në bashkëkryerje dhe “mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Prokuroria Themelore tha se, përveç pesë të plagosurve, autoritetet po punojnë për identifikimin e personave të tjerë që dyshohet se janë përfshirë në të shtënave në Prishtinë.



A po nxitet një konflikt i ri i armatosur



Shkruan: Milazim KRASNIQI

Edhe nga zhvillimet e kohëve të fundit nxirret lehtë përfundimi logjik se Kosova as nuk ka pasur as nuk ka politikë të qartë lidhur me serbët e Kosovës e aq më pak për

konfliktin e hapur me Serbinë. Politika e qeverive të Kosovës ka qenë reaktive, pra, reagim ndaj veprimeve agresive të serbëve lokalë e të shtetit serb, ose kompromise të mëdha, për hatër të faktorëve ndërkombëtar. Kështu kemi ardhur në këtë situatë absurde ku njëzet e gjashtë vite pas pavarësisë, serbët protestojnë për institucionet e Serbisë dhe faktorët ndërkombëtar i bëjnë presion Kosovës për të mos mbyll ato institucione, të cilat janë zgjatime të okupatorit serb. Këtu vetëm logjikë nuk ka. Këtu ka vetëm

dështim të qeverive të Kosovës, nga e para deri te kjo e fundit dhe hipokrizi të faktorëve ndërkombëtar, nga i pari tek i fundit.

Çka është dashur të bëhej? Kushti i parë për të formuar komunat e reja dhe për të mbajtur zgjedhjet lokale, si në dialogun në Vjenë ashtu edhe në Bruksel, do të duhej të ishte mbyllja e atyre institucioneve. Nuk e kanë vënë atë kusht prandaj po i vuajmë pasojat.

E dyta, procesi i pacifikimit në veri, i filluar para dy vitesh nga qeveria Kurti, nuk do të duhej të

fillonte nga tabelat, nga zgjedhjet, nga ura e Ibrit, po pikërisht nga mbyllja e këtyre institucioneve paralele, zgjatime të okupatorit. Për këto dy vite është harxhuar shumë energji e edhe kredibiliteti i Kosovës me çështjen e tabelave, kryetarëve të komunave, dinarit, postës, ndërsa themeli i të gjitha atyre kanë qenë pikërisht organet paralelet të Serbisë në Kosovë. Nga ky aspekt, kërkesat e faktorëve ndërkombëtar, për të mos mbyll këto organe të okupatorit, vërtet janë absurditet i llojit të vet. Kjo kërkesë absurde dëshmon gjithësesi se faktorët

ndërkombëtar nuk kanë politikë të qartë për Kosovën, aq më pak për konfliktin e hapur ndërmjet Kosovës e Serbisë. Më gjasë edhe ajo politikë që kanë pasur, po rrëshqet drejt nxitjes së një konflikti të ri. Ka rrezik që edhe vetë nxitja e Kurtit për “pacifikimin” e veriut e ka pasur për synim që të arrihet në pikën e konfliktit të pashmangshëm, për të zgjidhur pastaj krizën e re në favor të Serbisë- me një autonomi substanciale për veriun. Si dhuratë për litiumin dhe për armët që po dërgon Serbia në Ukrainë.

Në objektet ku ishin institucionet paralele serbe vendosen pllaka të ministrive të Kosovës

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Pllaka me emra të ministrive të Kosovës janë vendosur në një ndërtesë në Mitrovicë të Veriut, që më herët kishin qenë të vendosura institucione paralele të Serbisë. Në këtë objekt komunal, që gjendet në Lagjen e Boshnjakëve, paraprakisht kishin qenë të vendosura institucione që financohen nga Serbia: Zyra për Kosovën, Drejtoria e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, Qarku Administrativ i Mitrovicës së Kosovës dhe Qendra për Punë Sociale nga Vushtrria.

Ndërkaq, në objektin ku deri para pak ditësh ishte vendosur komuna paralele e Mitrovicës, është vendosur tabela që tregon se aty gjendet Departamenti për Patentë Shoferë, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Më 30 gusht, përmes një aksioni të



kryer nga Policia e Kosovës, në katër komunat në veri të Kosovës u mbyllën objekte të pesë

institucioneve paralele serbe. Nga Qeveria e Kosovës thanë se këto institucione funksiononin në

udhëheqjen e Serbisë dhe cenonin kushtetutshmërinë e vendit.

Aksioni u kritikua nga bashkësia ndërkombëtare, që e quajti veprim të njëanshëm dhe të pakoordinuar.

Më herët gjatë këtij viti, autoritetet e Kosovës mbyllën edhe shtatë komuna të tjera paralele serbe në pjesë të tjera të Kosovës.

Në Kosovë ka komuna, kompani dhe ndërmarrje publike, çerdhe, shkolla fillore, të mesme dhe universitete publike që financohen drejtpërdrejt nga Qeveria e Serbisë, të cilat gjenden në qytetet dhe vendbanimet ku jeton komuniteti serb.

Këto institucione, sipas ligjeve në Kosovë, janë ilegale.

Më 2013 Kosova dhe Serbia, në dialogun për normalizimin e raporteve në Bruksel, kishin arritur një marrëveshje për shuarjen e institucioneve paralele, por ende kjo marrëveshje nuk është zbatuar plotësisht.

Aivo Orav, shef i ri i zyrës së BE-së në Kosovë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Diplomati estonez Aivo Orav do të jetë shef i ri i Zyrës së BE-së në Kosovë. Ai ka marrë detyrën nga Tomasz Szunyog, i cili ka shërbyer deri më tani në këtë detyrë. Orav ka thënë se do të punojë ngushtë për ta mbështetur rrugën e Kosovës drejt BE-së. “Me kënaqësi të madhe dhe

një ndjenjë të thellë të përgjegjësisë po e marr postin e shefit të zyrës së BE-së/përfaqësuesit special të BE-së në Kosovë, një partner i rëndësishëm i BE-së në Ballkanin Perëndimor. Zotohem se do të punoj krah për krah me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë të BE-së në Kosovë për t'i

çuar përpara marrëdhëniet tona diplomatike dhe politike, për ta konsoliduar pozitën e BE-së si investitor, partner tregtar dhe donator më i madh i Kosovës dhe për ta mbështetur rrugën e Kosovës drejt BE-së dhe reformat në lidhje me BE-në”, ka shkruar Orav në platformën “X”.



Diasporës i bëhet thirrje të mos i marrë shtesat e fëmijëve në Kosovë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kualifikimi për përfitim të shtesave është për të gjithë fëmijët nga 0 deri në 16 vjeç për të cilët janë shtetas të Kosovës dhe jetojnë në Kosovë, kështu tha në një konferencë për medie ministri i Financave, Hekuran Murati. E përfitues të këtyre shtesave janë rreth 403 mijë fëmijë shtetas të Kosovës.

Në lidhje me raste të cilat përfitues të këtyre shtesave janë fëmijët shtetas të Kosovës, por që jetojnë në diasporë e marrin përfitime të tilla, ministri Murati kërkoi që të sinjalizohen raste të tilla. Por, ish-ministri i Financave, Haki Shatri, në një prononcim për "Gazetablic", tha se nuk është në dijeni nëse ka raste të tilla ku, sipas

tij, nuk është "fer" që të marrin këtu një pjesë të buxhetit që është shumë i vogël.

Ndërsa ekonomisti Ismet Mulaj kërkoi të rishikohet legjislacioni aktual në mënyrë që të ketë një qasje të drejtë dhe që, sipas tij, përfitimet duhet të shkojnë vetëm tek ata fëmijë që kanë qëndrim të përhershëm në Kosovë.



Gastronomët ankohen se iu ka rënë puna, tregojnë disa arsye që kanë çuar në ulje

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Sektori i gastronomisë në Kosovë është duke u ballafaquar me një lloj krize të qarkullimit të punës, sidomos pas liberalizimit të vizave për qytetarët. Kështu ka thënë për "KosovaPress", sekretari i Shoqatës së Gastronomëve, Arian Vranica, i cili ka theksuar se kjo sezon verore për gastronominë nuk ishte dhe aq me fat.

Vranica thotë se në këtë krizë të gastronomisë ka ndikuar edhe liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës, pasi që shumica e punëtorëve në këtë sektor kanë lëshuar vendet e tyre të punës për një jetë më të mirë.

Vranica ka thënë se në për sallat e dasmave ka pasur një ulje të interesimit për organizimin e ahengjeve, në këtë rast për dasmat. "Ka pasur rritje, por ajo periudhë ka qenë e shkurtër, nëse krahasojmë me vitin e kaluar, në përgjithësi si gastronomi, edhe në sektorë ku përfshijnë salla të dasmave,



diskotekat, jeta e natës, restaurantet, baret, kafenetë, mesatarisht mund të themi se në sektor, për shembull, për sallat e dasmave ka pasur një ulje të interesimit për organizime të

tilla. Është duke kapërcyer një lloj krize, që nuk e di se a është ndërrimi i gjeneratave, apo çka është më shumë si pasojë e kësaj", ka thënë Vranica.

Sipas Vranicës, nga ana e

bizneseve ka pasur ankesa të shumta pasi që, sipas tyre, ka edhe një ulje të qarkullimit dhe të aftësisë shpenzuese në përgjithësi të njerëzve.

Vranica shton se punëtorët e këtij

sektori nuk po mund t'ia dalin mjaftueshëm me të ardhurat mujore. "Ka pasur ankesa shumë nga bizneset sepse ka pasur, sipas tyre, edhe një ulje të qarkullimit dhe të aftësisë shpenzuese në përgjithësi të njerëzve, sepse nuk është që po kalojnë në një krizë ekonomike vetëm qytetarët. Po shihen pasojat jo vetëm në kuptimin e qarkullimit, por edhe të menaxhimit të brendshëm ku punëtorët nuk po mund t'ia dalin mjaftueshëm për ta çuar muajin e tyre ashtu siç duhet. Por është një raport shumë i ndërlikuar mes kërkesës dhe ofertës që po determinon dhe reflekton problemet e tilla", ka shtuar ai.

Vranica shton se, sipas disa hulumtimeve që ai ka bërë, mbi 100 mijë persona kanë provuar të gjejnë punë në vende të tjera. Përveç ankesave nga sektori i gastronomisë, edhe qytetarët ankohen për shtrenjtimin e pijeve dhe ushqimit në kafetarët e natës gjatë sezonit veror.

Çmimet e konsumit shënojnë ngritje 2.2 %



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Çmimet e konsumit në muajin korrik shënuan ngritje prej 2.2%. E rritja e këtyre çmimeve sipas ekonomistëve ka rënduar edhe jetesën e banorëve në Kosovë. Madje shumë prej tyre është dashtë të marrin kredi për dalje nga kriza.

Heqja e vizave ka ndikuar edhe në rritjen e çmimit të biletave të fluturimit.

Krahasuar me korrikun e vitit të kaluar, këtë vit, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave, biletat

janë shtrenjtuar për 22%.

Po jo vetëm çmimet e biletave të fluturimeve, edhe kafja, çaji, pijet alkoolike, lëndët djegëse shënuan rritje të çmimeve. Por, sipas profesorëve të ekonomisë, ky trend i ngritjeve të çmimeve po vazhdon tash e një kohë. Madje gjendja është rënduar saqë për të dalë nga kriza shumë familja janë detyruar të marrin kredi.

Për profesorin Mustafë Kadrijaj, për shkak të inflacionit të lartë, jeta e qytetarëve në Kosovë është rënduar. "Vetë fakti që qeveria

kreket që ne po e mbushim arkën e shtetit përmes doganës kjo tregon që ne kemi importin e lartë dhe në momentin që e ke importin e lartë, ti je i diktuar nga çmimet dhe inflacioni dhe, për fat jo të mirë, nga viti në vit ka ndryshime e kjo po e rëndon jetën e qytetarëve, e kur flasim për të hyra, nuk kemi ndonjë përmirësim", tha Kadrijaj. Sipas ASK-së, shkalla e inflacionit në Kosovë në muajin korrik ka shënuar vlerën 2.2% krahasuar me muajin korrik 2023.

Rënie e lehtë e prodhimeve bimore dhe blegtorale në Kosovë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Llogaritë ekonomike për bujqësi" për vitin 2023. Në vitin 2023 prodhimet bimore kanë shënuar rënie për -11,6%, krahasuar me vitin 2022. Rënia në vlerën e prodhimeve bimore mund të shpjegohet kryesisht me rënien e vlerës së prodhimit

të drithërave, bimëve foragjere, si dhe perimeve dhe prodhimeve të kopshetit. Prodhimet blegtorale kanë shënuar rritje për 19,3% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Rritja mund të shpjegohet me rritjen e vlerës së produkteve blegtorale. Llogaritë ekonomike në bujqësi 2023 janë hartuar sipas metodologjisë së

përcaktuar nga Eurostati: Udhëzuesi i Llogarive Ekonomike për Bujqësi dhe Pylltari EAA/EAF 97 (Rev.1.1) dhe Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 306/2005.

Ky publikim përfshin të dhëna për prodhimet bimore, prodhimet blegtorale dhe shpenzimet në fermë, në terma monetarë.



Kursku, beteja që ndryshoi narrativën e luftës



Kur pamjet filmike të inkursionit ukrainas në rajonin e Kurskut të Rosisë filluan të shfaqen në mediat sociale, një meme filloi të bënte xhiron e rrjetit. Aty shfaqej Vladimir Putini duke pyetur Stalinin se çfarë duhet të bënte për tanke gjermane që po vinin drejt Kurskut.

Fantazma e Stalinit i thotë se receta e fitores është e thjeshtë: dërgo në betejë divizionet më të mira ukrainase, siç kishte bërë ai në vitin 1943, pastaj kërko nga SHBA tanke dhe para. Por asnjë nga këto opsione nuk është në dispozicion të Putinit. Ai tani po përballet me ushtrinë ukrainase në tokën e tij dhe e konsideron SHBA-në si armikun kryesor.

Çdo vit që nga pushtimi rus, Ukraina ka habitur botën. Së pari, në fillimin e luftës në vitin 2022, forcat e saj zbrapsën një sulm rus në kryeqytetin, Kiev. Më pas, në vitin 2023, çliruan Khersonin. Tani, tanket e tyre janë futur në territorin rus. Forcat e armatosura të Ukrainës tashmë kontrollojnë rreth 1000 km katror tokë dhe më shumë se 80 vendbanime.

Flamujt rusë janë hequr; në qytetin Sudzha është ngritur një administratë ushtarake për të qeverisur territorin dhe janë kapur qindra robër lufte. Përfitimet territoriale të Kievit, në kontrast me madhësinë e territorit të Rosisë, janë, natyrisht, të vogla. Ushtria ukrainase ka marrë ekuivalentin e rreth 10% të Londrës së Madhe.

Inkursionit i Kurskut mund të mos jetë një betejë vendimtare në këtë luftë, por ndryshon rrënjësisht narrativën mbizotëruese se si po luftohet dhe si mund të përfundojë. Ajo godet rrënjën e strategjisë së Kremlinit, e cila ka qenë që perëndimi të ketë "arsye të mbërrijë në konkluzionin se mbizotërimi i Rosisë në Ukrainë është i pashmangshëm dhe se ne duhet të hiqemi mënjane", sipas Institutit për Studime të Luftës.

Kremlini ka qenë i suksesshëm me këtë narrativë, që nga fillimi i luftës. Si rezultat, perëndimi armatosi me shumë kujdes trupat ukrainase dhe vendosi kufizime në përdorimin e sistemeve të tij të armëve, duke e detyruar Ukrainën

të luftojë me njërin dorë të lidhur pas shpine. Ndërkohë, Putini grumbulloi trupa dhe pajisje dhe ndezi flakë vijën e frontit lindor, duke lëshuar bomba nga bazat ajrore ruse, duke e ditur se Ukraina nuk mund të kundërpërgjigjej përpara se aeroplanët të fillonin sulmet.

Ofensiva e Kurskut po e kthen këtë narrativë në favor të Kievit. Kjo tregon se kjo luftë nuk ka ngecur. Në muajt e fundit, forcat ukrainase kanë kryer një sërë operacionesh dinamike. Një nga fitoret e tyre më domethënëse është pastrimi i Detit të Zi për lundrim tregtar duke shkatërruar 30% të flotës ruse dhe duke i shtyrë anijet e mbetura përsëri në bazat në Detin Azov.

Sulmet e sakta me dron që shkatërruan mbrojtjet ajrore të sofistikuara ruse dhe aeroportet në gadishullin e Krimesë kanë qenë gjithashtu integrale. Thellë brenda Rosisë, më shumë se 30 nga rafineritë më të mëdha të naftës janë nën sulmet e vazhdueshme që nga marsi, duke çuar në një rënie të prodhimit të

naftës dhe një rënie prej 30% të shitjeve të naftës. Me Kurskun, tashmë kemi forca armike që pushtojnë territorin rus për herë të parë që nga Lufta e Dytë Botërore. Ukraina ka marrë më shumë toka ruse, se sa Rusia ka kapur brenda Ukrainës, që nga fillimi i vitit 2024.

Ngjarjet e dy javëve të fundit kanë treguar se Ukraina mund të ecë nëpër vijat e kuqe ruse, pa u ndëshkuar. Ofensiva ka thyer gjithashtu një tabu në lidhje me përdorimin e pajisjeve perëndimore brenda Rosisë, e cila duket se e ka një efekt: Shtëpia e Bardhë thuhet se po konsideron ofrimin e raketave me rreze të gjatë veprimi për të shoqëruar avionët F-16 që ajo ka dërguar, gjë që mund të komplikojë përpjekjet e Rosisë për të rimarrë territorin e saj. Në fund të fundit, Kursku jep përgjigjen më të mirë ndaj argumentit se Ukraina duhet t'i japë fund kësaj lufte duke shkëmbyer territorin e saj për paqen, e cila ishte gjithmonë e bazuar në besimin se Ukraina nuk mund të konkurronte në fushën e

betejës.

Shtyrja e Ukrainës për të bërë kompromis, për të pranuar aneksimin e tokave të saj dhe për të ndaluar kërkimin e drejtësisë për këtë luftë, në thelb nuk vlerëson vendosmërinë e popullit ukrainas dhe forcën e ushtrisë së tij. Ky inkursion tregon se ata janë të aftë për triumfe ushtarake dhe se ndihma perëndimore shpërblehet. Është teatri ushtarak, jo tryeza e bisedimeve, ajo që do të përcaktojë rezultatit e kësaj lufte. A do të jetë në gjendje Ukraina të shfrytëzojë plotësisht suksesin e saj në Kursk? Ushtarët e saj po konsolidojnë territorin që kanë kapur, krijojnë mbrojtje dhe avancojnë ku të mundën. Rusët po përgatiten të nisin një kundërsulm dhe të ndërtojnë linja mbrojtëse për të ndaluar përparimin e Kievit. Por episodi është një poshtërim për Putinin. Kiev do të shpresojë të përfitojë nga kjo dhe të detyrojë qeveritë perëndimore të angazhojnë burime të mëtejshme. Loja e re ka filluar. / The Guardian – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



FBK-ja i uron Hajrizit shërim dhe rikthim të shpejtë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Federata e Basketbollit e Kosovës i uron shërim sa më të shpejtë basketbollistit të Kosovës, Drion Hajrizi. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe Bordi Ekzekutiv i FBK-së,

besojnë që Hajrizi do të rikthehet sa më shpejt në parket, aty ku e ka vendin dhe aty ku ka dhënë kontribut të madh në basketbollin e Kosovës. Driloni ka luajtur rregullisht për Kosovën, që nga pranimitë në

FIBA deri në ndeshjet e fundit. Basketbollisti mitrovicas ka 29 ndeshje me dardanët, duke luftuar gjithmonë për çdo top dhe duke qenë ndër më të dalluarit. Ai u shpall basketbollisti më i mirë për vitin

2023 nga Federata e Basketbollit e Kosovës, ndërsa në karrierën e tij ka fituar shumë çmime individuale dhe ekipore. "Drilën e presim në parket më të fortë se kurrë", thuhet në postimin e FBK-së.



Foda: Synojmë fitore kundër Rumanisë dhe vendin e parë në grup

Kosova të premtën e fillon edicionin e ri në Ligën e Kombeve me përballjen ndaj Rumanisë, kurse tri ditë më vonë luan ndaj Qipros. Trajneri Franco Foda ka bërë me dije se fitorja është synim në ndeshjen e parë dhe më pas triumfi në grup

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ndeshjen e parë në Ligën e Kombeve për edicionin e ri e zhvillon të premtën në stadiumin "Fadil Vokrri" ndaj Rumanisë. Përzgjedhësi Franco Foda ka thënë se synim i "dardanëve" është ta nisnin me fitore këtë edicion të Ligës së Kombeve. "I kemi përfunduar ndeshjet miqësore dhe tash po përgatitemi për Ligën e Kombeve. Të gjithë lojtarët janë në formë të shkëlqyeshme dhe për lojën e parë në shtëpi jemi jashtëzakonisht të motivuar. Do

të bëjmë gjithçka që të fitojmë kundër Rumanisë", ka thënë Foda, i cili më pas ka folur edhe për synimet. Ai ka thënë se synon të fitohet grupi, ani pse nuk e kanë patjetër të llogariten si favoritë. "Ne nuk e kemi qëllim të jemi gjithsesi favoritë të grupit. Qëllimi i parë dhe më i rëndësishëm është pikë së pari ta fitojmë lojën e ardhshme (ndaj Rumanisë). Pastaj, sigurisht se synojmë t'i fitojmë lojtarët dhe të jemi të parët në grup", ka shtuar trajneri gjerman.

Foda më pas ka folur edhe për dy talentët Eliot Bujupi dhe Albion Rrahmani. "Eliot Bujupi është një lojtar i ri, por me aftësi të jashtëzakonshme për shënimin e



golave. E kemi ndjekur nga afër dhe ai ka treguar lojërë të shkëlqyera në dy ndeshje. Për këtë arsye e kemi ftuar që të jetë pjesë e ekipit dhe të përshtatet. Albioni është një lojtar shumë i talentuar.

Ai ka bërë një hap të rëndësishëm në karrierën e tij duke kaluar te Sparta Praga dhe tani është momenti që të dëshmojë vlerat e tij edhe në kombëtare", ka deklaruar Foda.

Strategu gjerman nuk ka dhënë detaje lidhur me formacionin kundër Rumanisë, duke thënë se gjithçka do të vendoset pas stërvitjeve të ardhshme. "Kemi shumë opsione në ofensivë, duke përfshirë Muriqin, Asllanin, Bujupin, Albionin dhe Rashicën. Gjithçka do të varet nga stërvitjet e ardhshme dhe se si do të paraqiten lojtarët", ka pohuar ai.

Ndërsa menaxheri i Përfaqësueses së Kosovës, Bajram Shala, ka folur rreth çështjes së Donis Avdijajt dhe Besfort Zenelit. "Çështja e Donis Avdijajt është e mbyllur që një kohë të gjatë për shkak të një incidenti të mëparshëm dhe ka qenë një vendim intern i federatës për çështjen e tij. Tani fokusi ynë është te futbollistët që janë këtu. Sa i përket Besfort Zenelit ai e ka pasur ftesën e trajnerit për këtë grumbullim, por ka vendosur të mos jetë pjesë e ekipit. Ne do të vazhdojmë të flasim me të dhe me familjen e tij për të ardhmen", ka thënë Shala.

FC Ballkani konfirmon largimin e Dajës: Faleminderit kampion!



SUHAREKË, 2 SHTATOR - Skuadra kampione në fuqi e Kosovës në futboll, Ballkani, ka konfirmuar largimin e trajnerit Ilir Daja. Skuadra nga Suhareka e ka falënderuar trajnerin Daja për kontributin e madh që ka dhënë në klub, derisa është zotuar se do të bëjë zgjedhjen më të mirë për pasardhës të Ilir Dajës në krye të shtabit teknik. "Faleminderit Ilir

Daja! Për mbi dy vjet e gjysmë kemi rrugëtuar bashkë, me shumë punë, suksese, shumë trofe e përjetime të mëdha. Tifoze të dashur, pavarësisht se në vazhdimësi kemi qenë të dakorduar për të vazhduar edhe më tej bashkë, tashmë ish-timonieri ynë ka konsideruar se nuk ka më shumë çfarë të jap për klubin tonë. FC Ballkani është

klub i madh dhe duke qenë i tillë, do ta bëj zgjidhjen e duhur edhe në krye të shtabit teknik, gjithmonë me të njëjtat ambicie e objektiva, në ndjekje të çdo trofeu. Kurse ecuria e Ballkanit me trajnerin Daja në krye të skuadrës, do të mbetet etapë shumë e rëndësishme e historisë sonë. Faleminderit kampion!", thuhet në njoftimin e FC Ballkani.

Llapi: Gjendja e Veliut është stabile

PODUJEVË, 2 SHTATOR - Futbollisti Valmir Veliu është lënduar në ndeshjen në mes të Prishtinës dhe Llapi ku është përplasur kokë me kokë me një lojtar kundërshtar. Skuadra e Llapi sot ka njoftuar se gjendja e futbollistit Veliu është stabile. "Klubi Futbollit Llapi njofton opinionin se gjendja e

futbollistit Valmir Veliu pas dëmtimit të pësuar në ndeshjen me Prishtinën është stabile dhe jashtë rrezikut falë edhe intervenimit të shpejtë të stafit mjekësor. Përplasia kokë me kokë mes tij dhe qendërmbrojtësit të Prishtinës, Ardi Ajdini, bëri që Veliu të pësojë çarje të arkadës, me

ç'rast futbollisti u dashtë të dërgohej me urgjencë drejt qendrës emergjente për mjekim të mëtuqjeshëm. Veliu ka kaluar me sukses edhe këtë sfidë, ndërsa ne e presim të rikthehet edhe më i fortë që t'i ndihmoj ekipit drejt realizimit të objektivave", thuhet në njoftimin e Llapi.



710 ndeshje për Bayernin, rekordmeni Muller: Më interesonte vetëm fitorja

MÜNCHEN, 2 SHTATOR - Bayern München siguroi një fitore 2-0 në shtëpi kundër Freiburgut. Lojtari i ndeshjes ishte padyshim njeriu "rekord" Thomas Muller, i cili festoi me vetë fansat e tij pas ndeshjes. Mulleri siguroi vendin e tij në librat e historisë disa kohë më

parë. 34-vjeçari kurorëzoi karrierën e tij të jashtëzakonshme me paraqitjen kundër Freiburgut. Futbollisti 34-vjeçar hyri si zëvendësues në minutën e 58 dhe u bë lojtari i ri rekordmen i gjigantëve nga Muncheni. "Bavarezi" ka luajtur 710

ndeshje për Bayernin, më shumë sesa kushdo tjetër në historinë e klubit. "Jam i lumtur për golin". Pas ndeshjes Mulleri dhe skuadra festuan me tifozët. Pak kohë më vonë ultrasit sollën sulmuesin në gardh dhe e nderuan atë për arritjen e tij të re. Vetë sulmuesi ishte

relativisht i qetë: "Rekordi nuk është aq i rëndësishëm për mua. Nuk më intereson nëse janë 710, 712 apo 325 ndeshje". Ai ishte mjaft i emocionuar me golin e tij për t'i dërguar shifrat 2-0: "Jam më i lumtur për golin. Kjo ishte teknikisht e shkëlqyer".



Sylvinho ndryshon listën, 'ikën' Broja, vjen Uzuni

TIRANË, 2 SHTATOR - Pas aventurës në "Euro 2024" në Gjermani, tashmë shtatori do të rikthejë sërish emocione kuqezi. Kombëtarja shqiptare ka nisur punën e plotë për ndeshjet e Ligës së Kombeve. Kuqezinjtë do të luajnë dy duele ndaj Ukrainës dhe Gjeorgjisë, sfida këto të vlefshme për Ligën e Kombeve. Këto janë përballjet e para për "djemtë" e Sylvinhos, të cilët ndodhen në Ligën B dhe grupin B1, ku ndaj ukrainasve luajnë më 7 shtator në transfertë dhe ndaj gjeorgjianëve më 10 shtator.

Ndërkohë trajneri Sylvinho ka dalë në konferencën e parë për shtyp në prag të grumbullimit. "Armando Broja nuk do të jetë në dispozicion me ne. Kemi mbetur në kontakt me stafin mjekësor të ekipit të tij dhe na kanë njoftuar se ka një problem me tendinën e Akilit dhe do t'i duhen rreth 10 ditë rikuperim, kështu vendosëm ta zëvendësojmë me Uzunin", ka thënë Sylvinho, i cili më pas ka folur për portierin Etrit Berisha, i cili mungon në këtë grumbullim. "Kombëtarja është e



hapur për të gjithë. Berisha nuk ka një kontratë. Prandaj e humbet këtë periudhë. Po punojmë për ta ndërtuar ekipin, kështu që është e hapur për në vazhdim", ka shtuar ai. I pyetur se a e ka kontaktuar Brajan Grugën, Sylvinho: "Një pjesë e rëndësishme e punës sot është mbledhja e talenteve. Kemi tre milionë banorë në Shqipëri, por shumë të tjerë janë jashtë. Është e vështirë, nuk është një punë sekrete. Ai ka dy nacionalitete. Kur lojtarët kanë interes, ata

kontaktohen. Nuk mund të them se çfarë po bëhet konkretisht, por po bëhet një punë shumë e mirë". "Liga e Kombeve na jep një dorë të mirë për botërorin. Ndeshjet me Ukrainën, Gjeorgjinë dhe Çekinë do të jenë të forta. Jemi një kombëtare që po rritet. Në listën që kemi përpiluar vetëm Zeka dhe Spahiu janë thirrur për herë të parë. Duhet të bëjmë vlerësime, por jo eksperimente. Ne futemi në fushë me shpirt dhe me zemër", ka deklaruar Sylvinho.

Verstappeni: Kështu nuk fitojmë asnjë titull

MONZA, 2 SHTATOR - "Lufta për titullin e konstruktorëve? Për momentin, në të dy kampionatet gara është e hapur. Të mendosh se e ke fituar titullin është diçka joreale". Me këto fjalë, Max Verstappen hapi zyrtarisht krizën e Red Bullit, duke pasur parasysh se ata kanë gjashtë gara radhazi pa fitore. Ai ka thënë se situata, në të dyja renditjet, po ikën nga kontrolli. Red Bulli ka vetëm tetë pikë avantazh ndaj McLarenit të konstruktorët. Ndërsa në renditjen për pilotë, Verstappeni ka ende 62 avantazh ndaj Lando Norris. Falë fitores së Charles Leclerc, i cili i dha një dorë të madhe holandezit. "Dëmtim i kufizuar? Në njëfarë kuptimi po, por nuk më pëlqen ta



shikoj kështu kampionatin. Ne duhet të përqijemi të jemi arkitektët e fatit tonë, por sot kjo është ajo që kemi. Nuk më intereson se si jemi për momentin, jemi keq kudo. Kështu që ne kemi nevojë për shumë ndryshime", ka thënë holandezit, që pranon vështirësitë që ka makina Red Bull Racing. "Në Monza nuk isha në gjendje ta shfrytëzoja plotësisht fuqinë e motorit. Kishim një problem të vogël dhe mendoj se edhe nga pikëpamja strategjike mund të kishim bërë një punë më të mirë, për të qenë më konkurrues. Nuk do ta ndryshonte pozicionin, por mendoj se ne nuk e kishim garën tonë optimale", ka deklaruar Verstappen.

SHKURT

Motta: Barazimi ndaj Romës ishte rezultat i drejtë

Juventus ka barazuar me Romën (0-0), derisa trajneri Thiago Motta mendon se ndaj Romës ishte një lojë e ekuilibruar dhe barazimi një rezultat i drejtë. "Ishte një lojë e ekuilibruar ku Roma na detyroi të tërhiqemi në krahun e djathtë, por në pjesën e dytë ne dolëm më mirë, patëm më shumë topin dhe u përpoqëm të luajmë në pjesën e tyre. Mendoj se rezultati ishte i drejtë. Roma e meriton për ngadalësimin e ritmit, ishte e vështirë për ne që të shpërthenim dhe t'i shkonim përpara. Ka shumë gjëra që mund të përmirësojmë për ta ngritur nivelin ndaj kundërshtarëve të mirë. Ishte jashtëzakonisht lojë e ekuilibruar", ka thënë Motta.

Abraham: Krenar që debutova me fanellën e Milanit

I ardhur vetëm në orët e fundit të afatit kalimtar të verës, sulmuesi anglez Tammy Abraham debutoi me fanellën e Milanit në ndeshjen e fundit në Serinë A, ku kuqezinjtë barazuan 2-2 në fushën e Lazios. 26-vjeçari luajti si zëvendësues, duke u aktivizuar në 20 minutat e fundit. Gjithsesi, për të ky moment ishte mjaft i rëndësishëm. "Jam shumë krenar që e vesh këtë fanellë për herë të parë", u shpreh Abraham. "Natyrisht që donim fitoren, por rëndësi ka që reaguam dhe morëm një barazim. Jam gati ta ndihmoj ekipin", u shpreh sulmuesi anglez.

Salah: Ky është sezoni im i fundit në Liverpool

Momo Salah ka shkëlqyer në fitoren e Liverpoolit në derbin ndaj Manchester Unitedit në "Old Trafford", duke shënuar një gol dhe dhuruar dy asistime. Pas ndeshjes, ylli i futbollit nga Egjipti bëri me dije se ky do të jetë sezoni i fundit me fanellën e Liverpoolit. "Ky është viti im i fundit te Liverpooli. Dua vetëm ta shijoj, nuk dua të mendoj për fundin. Ndihej i lirë të luaj futboll, më pas do të shohim se çfarë do të ndodhë pas një viti", ka thënë Salah për "Sky Sport".

Ten Hag: Nuk jam Harry Potter, na duhet kohë

Manchester Unitedi pësoi humbje në derbin ndaj Liverpoolit (0-3). Trajneri Erik Ten Hag ka thënë se Unitedit i duhet kohë për faktin se është duke e ndërtuar një skuadër e re. Ai beson se mund të ngrehin trofe në fund të sezonit. "Nuk është se unë jam Harry Potter. Është e vështirë të flasësh për gjera pozitive pas një humbjeje të tillë. Më vjen keq, më vjen keq, mbi të gjitha, për tifozët. Kjo është vetëm ndeshja e tretë. Na duhet kohë pasi po ndërtojmë një skuadër të re. Jam i sigurt se deri në përfundim të sezonit do të kemi mundësi për të ngritur trofe", u shpreh Ten Hag.

Skandal në Lojërat Paraolimpike, ka edhe persona që nuk janë me aftësi të kufizuara

Observatori i Sporteve Ekuadoriane (ODDE) ka denoncuar një rast korrupsioni në shkallë të gjerë, që lejon pjesëmarrjen e personave pa aftësi të kufizuara në Lojërat Paraolimpike që po zhvillohen në Paris. Në një letër drejtuar presidentit të Parlamentit të Ekuadorit, Henry Kronfle Kozhaya,

Observatori Sportiv ka shkruar se personat pa asnjë aftësi të kufizuar kanë filluar të garojnë në ngjarje ndërkombëtare që nga Lojërat Parapan Amerikane në Toronto. Sipas ankesës së drejtuar nga ky "irret" i korrupsionit janë Santiago David Changó Pilataxi, drejtor teknik i Komitetit Paralimpik

Ekuadorian dhe Walter Oswaldo Haro Ruiz, drejtor teknik i Federatës Ekuadoriane të Sporteve për Personat me Aftësi të Kufizuara Intelektuale (Fededi). Ditët e fundit ish-trajneri i sportistëve paraolimpikë ekuadorianë, German Chala, kishte deklaruar për gazetën 'Express' se edhe në Lojërat

Paralimpike të Parisit që po zhvillohen në vazhdim, ka sportistë ekuadorianë me aftësi të kufizuara të rreme. Një nga provat që e dëshmojnë këtë, sipas Chala, janë patentat e drejtimit të tipit B të mbajtura nga disa sportistë paraolimpikë të delegacionit ekuadorian në Francë. "Deri në një

shkallë të caktuar invaliditeti mund të jepet licenca e tipit F por jo B. Diçka nuk është në rregull, si kanë aritur ta marrin nëse kanë një invaliditet nga 36% deri në mbi 60%?", raportoi ish-trajneri që konfirmoi se kishte marrë dënim për skemën e korrupsionit që në vitin 2014.



**KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI**
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriazhi" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjbiznesi.com, info@kolegjbiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **17.07.2024**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

SHBALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTAVE PËR VITIN AKADEMIK 2024/2025

01.07.2024 deri më 30.09.2024

<u>STUDIME BACHELOR</u>	<u>STUDIME MASTER</u>
1.BANKA DHE FINANCA NË BIZNES (BA) - (3 vjeçar) 2.MENAXHMENT DHE EKONOMIKS (BA) - (3 vjeçar) 3. SHKENCA KOMPJUTERIKE (BA)- (3 vjeçar)	1.MENAXHMENT DHE FINANCA – MA-(2 vjeçar) 2. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE -MA-(2 vjeçar)

Dokumentat e nevojshme për Aplikim BACHELOR	Dokumentat e nevojshme për Aplikim MASTER
Diplomën e shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar) Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar) Dëftesat e viteve (klasave) - I, II, III, / X, XI, XII (Original ose të noterizuar) Certifikatën e lindjes, Kopja e letërnjoftimit, Dy foto.	Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar) CV Certifikatën e lindjes Kopjen e letërnjoftimit Dy foto

www.kolegjbiznesi.com,
info@kolegjbiznesi.com

038/045/044- 500 878
049/ 048- 500 – 878
029-230-555 : 044 131027

ANKAND PUBLIK PËR SHITJEN E AUTOMJETEVE

Me datë 11.02.2022 Gjykata Themelore në Prishtinë ka marra Aktvendim me numër IV.EF.nr.2.2022 për falimentimin e kompanive Aksoy Group SH.P.K me NUI 811163617 dhe International Medicine Hospital SH.P.K me NUI 810800913. Administratori Falimentues me aprovimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas lëndës me numër FE. Nr. 11/22, Shpall shitjen përmes ankandit publik të veturave të përshkruara si më poshtë:

- Në këtë ankand shiten 6 automjete të cilat janë:
 - 3 vetura, Ford Fiesta me vitin e prodhimit 2012,
 - 1 veturë, Renault Z me vitin e prodhimit 2011
 - 1 autoambulancë, Citroen Jumper me vitin e prodhimit 2009
 - 1 minibus me 3 dyer, Mercedes Benz-Daimler Chrysler me vitin e prodhimit 2005.
- Afati për shiqimin e veturave** është deri me datën 07.09.2024.
- Adresa** ku gjenden veturat për të u shiqar është Rr. Nëna Terezë, Stacioni i Trenit, Fushë Kosovë (ish Fabrika e Miellit).
- Person kontaktues:** Genc Vitaku, me numër të tel: +38345983267.
- Dorëzimi dhe hapja e ofertave** bëhet me datë 09.09.2024 në ora 12:00.
- Ofertat** duhet dorëzuar në zarf të mbyllur.
- Dorëzimi i ofertave** bëhet në Prishtinë, Rr. Bekim Fehmiu, Lakrishtë, Ndërtesa "Arting", Kati 10, zyrja nr. 23.
- Me fituesin e ankandit do të lidhet kontrata për automjetet e blera.

>> SHBALLJE TË VOGLA <<

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 diplomën dhe certifikatën e testit të maturës të sh.m. mjekësisë.
- Behar Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Sabahate Dibra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Kaltrina Tabaku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Vjollca Hoti shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Blenisa Elezaj nga Ponosheci KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Ganimete Tërbeshi" Ponoshec KK Gjakovë nga kl. 6-9.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

